Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1151

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zvKryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahimi- Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Construmax" SH.P.K., kundër Mosekzekutimi i vendimit të OSHP-së të Ministria e Kulturës RS DHE ÇJK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Qendrës Nacionale të Xhudos- Palestrës, Ndërtesës shumë-funksionale dhe Bujtinës, në Pejë, në Komunën e Pejës- Ri-tenderim" me numër të prokurimit 207-24-2051-5-1-1, me 30/01/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Construmax" SH.P.K me nr. 2024/1151, e datës 27/11/2024, kurse vendimi i AK Ministria e Kulturës RS DHE ÇJK lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Qendrës Nacionale të Xhudos- Palestrës, Ndërtesës shumë-funksionale dhe Bujtinës, në Pejë, në Komunën e Pejës- Ri-tenderim" me numër të prokurimit 207-24-2051-5-1-1 anulohet 58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Kulturës RS DHE ÇJK, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 07.03.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Qendrës Nacionale të Xhudos- Palestrës, Ndërtesës shumë-funksionale dhe Bujtinës, në Pejë, në Komunën e Pejës- Ri-tenderim" me numër të prokurimit 207-24-2051-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 5,890.000€.

AK ka publikuar Njoftimi mbi vendimin e Anulimit te këtij aktivitetit te prokurimit (duke propozuar anulimin e aktivitetit në mungesë të ofertave të përgjegjeshme) me datën 08.11.2024.

OE "Construmax" SH.P.K me datën 13.11.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim. AK me datën 19.11.2024 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 27.11.2024 operatori "Construmax SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/1151 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak: (a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. OSHP-ja analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me ketë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me ketë, me 22.12.2024 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar,
- Të anulohet vendimi i AK-së për anulim të procedurës
- *Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE "Construmax SH.P.K."*

Përgjigje mbi pretendimin 1: Sa i përket pretendimit 1 nuk është i bazuar pasi që me datën: 15.07.2024, në orën: ll:34h, përfaqësuesit i GOE ka ardhur në Zyrë e Prokurimit pëifaqësuesi i GOE për qasje në dokumente. Nën prezencën e tij, drejtpërdrejte është shkarkuar para masa për aktivitetin, si dhe i njëjti është njoftuar për ofertat te cilat kanë kërkesa për sekret afarist. Përveç informatave sekrete afariste të cilat janë vlerësuar si të tilla nga AK, GOE ankues sipas kërkesës së tyre kanë pranuar me CD gjitha dokumentet tjera për aktivitetin e prokurimit të lartcekur. Gjatë shikimit të dokumenteve përfaqësuesi i GOE ka rezistuar që të merr gjitha dokumentet e pjesëmarrësve në këtë aktivitet të prokurimit por pasi që ka parë edhe vet në sistem ofertat e koduara me shenjën e sekretit afarist është pajtuar që dokumentet që përfshihen ne nenin 68 dhe 69 të mos i kërkojë por vazhdimisht ka kërkuar dokumentet siç janë: Garancinë bankare, Planin Dinamik sepse sipas tij janë dokumente që lexohen gjatë hapjes së ofertave. Zyra e Prokurimit, gjatë procesit të qasjes i ka bërë me dije se për shkak se GOE pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit kanë koduar ofertat e tyre me shenjën e sekretit afarist dhe kanë kërkesat e tyre për Sekret afarist sipas nenin 11 të LPP- së nuk mund të aprovojë një Kërkesë të tillë por vetëm dokumentet te cilat i lejohen. Po ashtu, gjatë procedurës së vlerësimit të ofertave si dhe gjatë procedurës së lejimit të qasjes në dokumente në asnjë rast AK- MKRS- konkretisht Zyrtarët e Prokurimit nuk e kanë shkelur nenin 1 - Qëllimi të LPP- së por çdo fazë e procedurës në fjalë është trajtuar dhe vlerësuar me ndershmëri, profesionalizëm dhe pa ndikim dhe jo ashtu siç pretendon GOE ankues, andaj gjitha pretendimet e lartë cekura të parashtruesit nuk e arsyetojnë faktin se parashtruesi nuk i ka plotësuar siç duhet kërkesat e AK dhe në ketë mënyrë ky pretendim është i pabazuar në tërësi e të cilat argumentohen me fakte nga AK- MKRS. (Provë: Oferta c GOE ankues, Njoftimi mbi Vendimin e AK dhe LS, Raporti i vlerësimit te ofertave, i datës: 12.07.2024).

Përgjigje mbi pretendimin 2: Lidhur me pretendimin me numër 2 të GOE ankues nuk e konteston faktin se është përgjigjur pozitivisht në kërkesën e AK. Autoriteti Kontraktues- MKR, ka vepruar duke u bazuar në nenin 30 të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik, paragrafi 30.4, ku ka kërkuar nga gjithë GOE pjesë marrës në aktivitetin e prokurimit të zgjasin vlefshmërinë e ofertave dhe vlefshmërinë e Sigurimit të Tenderit. Sipas, paragrafit 30.6 të nenit 30 të po kësaj Rregullore për Prokurimin Publik ka qenë e hapur kërkesa e AK që secili OE pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit të reagojë nëse dëshirojnë të përgjigjen pozitivisht në kërkesën e AK apo ta refuzojnë atë me arsyet që ju i keni cekur. AK- MKRS për këtë arsye ka lënë ne dispozicionin tuaj afatin e hapur prej pesë (5) ditëve ku ju mund t'i përgjigjeni pozitivisht apo ta refuzoni si kërkesë. Gjatë kësaj periudhe përmes sistemit elektronik E- Prokurimi, AK- MKRS ka pranuar përgjigje pozitive nga gjithë OE pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit duke zgjatur kështu vlefshmërinë e ofertave si dhe vlefshmërinë e Sigurimit te Tenderit sipas kërkesës së AK. Edhe nga ana juaj si GOE ankues, AK- MKRS ka pranuar dëshmitë për zgjatjen e vlefshmërisë së ofertave dhe vlefshmërisë së Sigurimit të Tenderit. (Provë: Kërkesa për zgjatje e AK, Dëshmia e GOE të bashkangjitura në sistemin elektronik E-Prokurimi). Bazuar në gjitha argumentet e lartë cekura, për vetë faktin se dhe ju si GOE jeni përgjigjur pozitivisht në kërkesën e AK gjitha pretendimet e prezantuara nga ana juaj nuk qëndrojnë duke potencuar këtu edhe faktin se pretendimet e juaj a kanë rënë në kundërshtim me veprimet tuaj a sepse ju e keni ngritur në sistemin elektronik E- Prokurimi vazhdimin e vlefshmërisë të ofertave dhe Sigurimit të Tenderit, andaj si pretendim është i pabazuar në tërësi.

Përgjigje mbi pretendimin 3: Lidhur me këtë pretendim keni rënë në kundërshtim me deklaratat tuaja, ku njëherë potenconi se jeni e vetmja ofertë qe keni zgjatur vlefshmërinë e ofertave dhe vlefshmërinë e sigurimit të Tenderit, pastaj deklaroni se dy ofertuesit e tjerë e kanë zgjatur vlefshmërinë e ofertave dhe te Sigurimit të Tenderit jashtë afatit. Andaj, ky pretendim hudhët poshtë si i pabazuar në tërësi sepse AK- MKRS ka vepruar bazuar në nenin 30 të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik, paragrafi 30.4, ka kërkuar nga gjithë OE pjesë marrës në aktivitetin e prokurimit, ku ka kërkuar nga secili ofertues zgjatjen e vlefshmërisë se ofertave dhe vlefshmërisë se Sigurimit të Tenderit duke e lënë në dispozicionin tuaj afatin e hapur prej pesë (5) ditëve ku ju mund t'i përgjigjeni pozitivisht apo ta refuzoni si kërkesë të AK. Andaj, gjitha supozimet dhe pretendimet e GOE ankues nuk qëndrojnë sepse Autoriteti Kontraktues nuk vepron mbi bazën e dëshirave por sipas Ligjit të Prokurimit Publik në fuqi ku bazuar ne nenin 60, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i LPP- së në fuqi kriteri për dhënien e kontratës ishte caktuar nga AK- MKRS Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në bazë të kritereve dhe peshën që është specifikuar në Aneksi 6 të Dosjes së Tenderit.

Përgjigje mbi pretendimin 4: Pretendim i GOE ankues që nuk ka qenë kriter e përzgjedhjes garancia e kualitetit, nuk mund të jetë e bazuar, sepse në DT ka qenë kriter i dhënies Tenderin, tenderuesi ekonomikisht me i favorshëm me nën kriteret në pjesën e caktuar të DT në Ankesi me numër 6, dhe në rast paqartësive OE gjatë fazës së tenderimit ka mund të kërkoj sqarime që janë të lejuar sipas nenin 16.1 Sqarimi i Dosjes së Tenderit. Edhe pse ju si GOE keni ofruar Deklaratë e garancionit e nënshkruar dhe e vulosur, mirëpo konsiderojmë që nuk keni përmbushur kërkesën c DT, pasi që do të duhej të ofroni edhe garancion gjithëpërfshirës që në dorëzim të ofertave, e jo ashtu siç pretendoni që këtë garancion ta dorëzoni pas përfundimit të punimeve.

Përgjigje mbi pretendimin 4: Komisioni i vlerësimit poashtu, ka vlerësuar me kujdes paramasën e ofruar nga ana juaj dhe ka konstatuar se gjatë llogaritjes nuk ka gabime aritmetikore mirëpo gjatë vlerësimit ka vërejtur te pozicioni me nr. rendor 2.1.1 në paramasën kryesore. Në ofertën tuaj është konstatuar nga komisioni i vlerësimit se keni ofruar çmimin për njësi ndërsa totalin e çmimit nuk e keni ofruar, dhe do të duhej të plotësoni edhe shumen Kedsi çmimi.

Përgjigje mbi pretendimin 5: Lidhur me këtë pretendim të GOE ankues nuk qëndrojnë deklaratat e supozuara të GOE ankues pasi që AK- MKRS e ka aprovuar kërkesën për qasje në dokumente sipas kërkesës së GOE ankues. Përfaqësuesi i GOE ka kërkuar nga Zyra e Prokurimit që të shkarkohet paramasa direkt nga sistemi elektronik E-Prokurimi dhe e njëjta paramasë të vërtetohet për pozicionin 2.1.1 të paramasës se ekziston gabimi siç është potencuar nga ana e tyrc. Përfaqësuesi i GOE ankues ka kërkuar të hapen ofertat dhe te shikohen nëse janë ngarkuar dokumentet në sistem në mënyrë që të vërtetohet ekzistenca e tyre po ashtu ka kërkuar hapjen e dokumenteve të cilat GOE pjesëmarrëse në aktivitetin e prokurimit i kanë markuar në sistemin elektronik E- Prokurimi me shenjën c sekretit afarist. Lidhur me këto kërkesa Zyra e Prokurimit, ka aprovuar si kërkesa dhe ka lejuar qasjen në dokumentet të cilat lejohen me LPP në fuqi. Asnjë deklaratë e GOE ankues nuk e konteston faktin se si ofertues në këtë aktivitet të prokurimit nuk i kanë plotësuar siç kërkohen nga AK- MKRS kushtet dhe kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Të gjitha deklaratat supozuese ndaj GOE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit janë arsyetime të tyre sepse AK- MKRS konkretisht komisioni i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave në mbështetje të nenit 59 të Ligjit nr./ 04/ L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/ L-237, Ligjin nr. 05/ L-068 dhe Ligjin nr. 05/ L- 092 ka konstatuar se asnjë ofertues bazuar në të gjeturat dhe gabimet e pariparueshme në këtë faze të prokurimit nuk është i përgjegjshëm. Po ashtu, edhe Zyra e

Prokurimit ka qenë korrekte gjatë lejimit të qasjes në dokumente dhe e pandikuar nga asnjë rrethanë e cila vërtetohet edhe me dëshmitë e bashkangjitura në sistemin elektronik E-Prokurimi. (Provë: Aprovimi i kërkesës për qasje në dokumente, Procesverbali për qasje në dokumente). Bazuar në gjitha argumentet e lartcekura, AK- MKRS ka konstatuar se edhe ky pretendim i GOE ankues është tërësisht i pabazuar.

Përgjigje mbi pretendimin 6: Lidhur me këtë pretendim, AK- MKRS sqaron se nuk mund t'i largojë dyshimet e GOE ankues por bazuar në gjithë dokumentacionin e vlerësuar konstaton se nuk qëndrojnë deklaratat e supozuara të GOE ankues, pasi që AK- MKRS ka vlerësuar ofertat e GOE pjesëmarrëse në aktivitetin e prokurimit sipas kushteve dhe kritere vetë vendosur anë Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dhe dëshmive të ofertuesve. Gjitha sqarimet të cilat janë kërkuar tek te gjithë OE pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit janë kërkuar në harmoni të plotë me nenin 72 të LPP- së si dhe nenin 38 të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik.

Përgjigje mbi pretendimin 7: Sa i përket këtij pretendimi nuk është kjo arsyeja e eliminimit të GOE pjesëmarrës nga aktiviteti i prokurimit i lartë cekur dhe ky pretendim i GOE ankues është tërësisht i pabazuar.

Përgjigje mbi pretendimin 8: Lidhur me këtë pretendim, AK- MKRS sqaron se nuk mund t'i largojë dyshimet e GOE ankues por bazuar në gjithë dokumentacionin e vlerësuar konstaton se nuk qëndrojnë deklaratat e supozuara të GOE ankues, pasi që AK- MKRS ka vlerësuar ofertat e GOE pjesëmarrëse në aktivitetin e prokurimit sipas kushteve dhe kritereve të vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dhe dëshmive të ofertuesve. Gjitha sqarimet të cilat janë kërkuar tek te gjithë OE pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit janë kërkuar në harmoni të plotë me nenin 72 të LPP- së si dhe nenin 38 të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik.

Përgjigje mbi pretendimin 9: Lidhur me këtë pretendim të GOE, duhet cekur se aktiviteti i prokurimit nuk është anuluar për këtë arsye, sepse nëse do të kishim oferta të përgjegjshme me mungesën e dëshmive të tilla dhe në raste të tilla AK-MKRS do të vepronte me sqarime komfor nenit 72 të LPP- së fuqi, nenit 26, paragrafit 26.6 të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik. Andaj si dhe nenit 10 të Udhëzuesit nr. 001/ 2023 për Prokurimin Publik andaj edhe ky pretendim i GOE ankues është tërësisht i pabazuar.

Përgjigje mbi pretendimin 10: Lidhur me këtë pretendim të GOE, duhet cekur se aktiviteti i prokurimit nuk është anuluar për këtë arsye, sepse nëse do të kishim oferta të përgjegjshme me mungesën e dëshmive të tilla dhe në raste të tilla AK- MKRS do të vepronte me sqarime komfor nenit 72 të LPP- së fuqi, nenit 26, paragrafit 26.6 të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik. Andaj si dhe nenit 10 të Udhëzuesit nr. 001/ 2023 për Prokurimin Publik andaj edhe ky pretendim i GOE ankues është tërësisht i pabazuar.

Përgjigje mbi pretendimin 11: Lidhur me këtë pretendim të GOE, duhet cekur se aktiviteti i prokurimit nuk është anuluar për këtë arsye, sepse nëse do të kishim oferta të përgjegjshme me mungesën e dëshmive të tilla dhe në raste të tilla AK- MKRS do të vepronte me sqarime komfor nenit 72 të LPP- së fuqi, nenit 26, paragrafit 26.6 të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik. Andaj si dhe nenit 10 të Udhëzuesit nr. 001/ 2023 për Prokurimin Publik andaj edhe ky pretendim i GOE ankues është tërësisht i pabazuar. Mirëpo, nëse gjatë vlerësimit të ofertave do të konstatohej mungesa e dëshmive të tilla megjithatë, lejohet sipas nenit 72 të LPP- së që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat

mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për Kontrate. Si përfundim, bazuar në gjitha argumentet e lartcekura edhe ky pretendim i GOE ankues është i pabazuar në tërësi.

Përgjigje mbi pretendimin 12: AK- MKRS lidhur me këtë pretendim nuk mund t'i largojë dyshimet e GOE ankues por bazuar në gjithë dokumentacionin e vlerësuar konstaton se nuk qëndrojnë deklaratat e supozuara të GOE ankues, pasi që AK- MKRS ka vlerësuar ofertat e GOE pjesëmarrëse në aktivitetin e prokurimit sipas kushteve dhe kritereve të vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dhe dëshmive të ofertuesve. Lidhur me këtë pretendim të GOE, duhet cekur se aktiviteti i prokurimit nuk është anuluar për këtë arsye, sepse nëse do të kishim oferta të përgjegjshme me mungesën e dëshmive të tilla dhe në raste të tilla AK-MKRS do të vepronte me sqarime komfor nenit 72 të LPP- së fuqi, nenit 26, paragrafit 26.6 të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik. Andaj si dhe nenit 10 të Udhëzuesit nr. 001/ 2023 për Prokurimin Publik andaj edhe ky pretendim i GOE ankues është tërësisht i pabazuar. Gjitha sqarimet të cilat janë kërkuar tek te gjithë OE pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit janë kërkuar në harmoni të plotë me nenin 72 të LPP- së si dhe nenin 38 të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik.

Përgjigje mbi pretendimin 13: Lidhur me këtë pretendim të GOE ankues nuk qëndrojnë deklaratat e supozuara të GOE ankues, pasi që AK- MKRS ka vlerësuar ofertat e GOE pjesëmarrëse në aktivitetin c prokurimit sipas kushteve dhe kritereve të vendosura në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit dhe kjo nuk është arsyeja e eliminimit të asnjërit prej pjesëmarrësve. GOE janë njoftuar përmes Letrave standarde për arsyet e eliminimit të ofertave të tyre, andaj ky pretendim është tërësisht i pabazuar. Mirëpo, edhe nëse do të ishin mungesa e dëshmive të tilla megjithatë, lejohet sipas nenit 72 të LPP- së që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për Kontrate. Andaj, bazuar në gjitha argumentet e lartcekura edhe ky pretendim i GOE ankues është i pabazuar në tërësi.

Përgjigje mbi pretendimin 14: AK- MKRS ka vepruar në pajtim me nenet e LPP- së në fiiqi si dhe ka respektuar nenin 7 sepse Autoriteti kontraktues i ka trajtuar gjithë GOE pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese si dhe ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave sipas nenit 59 të Ligjit nr. 04/ L 042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/ L- 237, Ligjin nr. 05/ L- 068 dhe Ligjin nr. 05/ L- 092 duke vepruar kështu në mënyrë transparente dhe korrekte për gjithë GOE pjesëmarrëse në aktivitetin e lartcekur të prokurimit. Vërejtje: Nga pretendimi me numër 6 i GOE ankues dhe deri tek pretendimi i fundit i GOE ankues me numër 16, gjithsej janë 10 pretendime të përsëritura me të njëjtat supozime që AK është përgjigjur pothuajse ne mënyrë të ngjashme me dyshimet dhe supozimet e ngritura nga ana e tyre. Si përfundim, është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij lidhur me përgjegjshmërinë e tij, dhe pretendimet e cituara edhe nëse janë të bazuara lejohen të kërkohen sqarime sipas nenin 72 të LPP-së dhe nenin 38 të Rregullores nr.001/2023 për Prokurim Publik, mirëpo për arsye që oferta e juaj ka qenë më e lira, dhe nuk janë vërejt gjetje tjera përpos garancionit dhe mosplotësimit të pozicionit 2.1.1, ku këto dy gjetje janë vërejt edhe te dy ofertuesit tjerë, nuk kem vazhduar me sqarime për dëshmi dokumentare që kanë mundur të ju mungojnë ofertuesve tjerë, apo gjetje tjera eliminuese. Njëkohësisht nga provat materiale të

administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuar. Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Bazuar në të thënat me sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Construmax SH.P.K." ne ankesën Nr. 1151/24 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (1): Ankuesi pretendon se: "Arsyetimi i parë eliminuese lidhur me vlerësimin e gjendjes ekonomike dhe financiare nuk është i bazuar, për faktin se kërkesa në Dosjen Teknike (DT) ka qenë që për tre vitet e fundit fiskale të dëshmohet se ka pasur të ardhura minimale prej 9,000,000.00 €. Data e publikimit të DT-së ka qenë më 07.03.2024, dhe për tri vitet e shkuara fiskale, jo vetëm që e plotësojmë këtë kërkesë, por edhe e tejkalojmë me rreth 2 milion euro. Kjo pasi që vetëm të hyrat pa TVSH janë 9.9 milion euro, ndërsa nëse llogaritim edhe TVSH-në, e cila ka qenë e njëjta vlerë si e ardhura, atëherë arrijmë në 11.7 milion euro. Ky arsyetim i eliminimit të grupit të OE-ve ankues nuk gjen mbështetje ligjore, përkatësisht neni 68 i LPP-së, paragrafi 1 përcakton: "...Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do ti referohen maksimum tri viteve të fundit financiare..." Marrë parasysh publikimin e njoftimit për kontratë dhe dosjen e tenderit, e cila përmban datën 07.03.2024, AK në asnjë rrethanë nuk mund të mos e marrë për bazë periudhën kohore të vitit fiskal 2024. Në kërkesën kualifikuese, AK në njërën anë ka kërkuar qarkullim për 3 vitet e shkuara fiskale, dhe në anën tjetër ka precizuar vitin 2020, vit ky i cili nuk mund të përcaktohet ligjërisht apo kufizohet. 6/10 Për më tepër, sipas Ligjit me nr. 04/L-077, për marrëdhëniet e detyrimeve, gjegjësisht nenit 86, përcaktohen dispozitat e paqarta në raste të veçanta, ku specifikohet: "Në rastin kur kontrata është lidhur sipas përmbajtjes së shtypur që më parë, ose kur kontrata ka qenë në ndonjë mënyrë e përgatitur dhe e propozuar nga njëra palë kontraktuese, dispozitat e paqarta do të interpretohen në dobi të palës tjetër". Andaj, arsyetimi i eliminimit për këtë pikë është ndoshta i ndikuar nga ofertuesit tjerë, pasi që ne si konsorcium kemi mbi 11,753,519.78 € të hyra në 3 vitet e shkuara fiskale, nga data e njoftimit për kontratë".

Pretendimi i dytë (2): Ankuesi pretendon se: "Arsyetimi i dytë i eliminimit lidhur me mungesën e fotografive në formularin Anesin/Tabelën 1 është një arsyetim i pabazuar në kërkesat e Doshjes Teknike (DT), për arsye se në dëshmit e kërkuara dokumentare ka qenë e specifikuar që ,, duhet te paraqes informacion mbi secilën kontrate për pune ndërtimore te zbatuar- nëpërmjet paraqitjes se të dhënave tekstuale dhe numerike, si dhe fotografive, në katër [4] faqe [bashkërisht me tabelën në vijim] me madhësi A4'' Konzorciumi ynë ka paraqitur informacionet për secilën kontratë të punëve ndërtimore përmes paraqitjes së të dhënave tekstuale dhe numerike. Po ashtu, kemi paraqitur edhe fotografi në 4 faqe për secilin projekt. Arsyetimi i eliminimit se ne si grup i OE-ve nuk kemi paraqitur fotografi është apsurd. Grupi ynë në ofertë ka prezantuar dëshmi ligjore, siç janë kontratat dhe raportet e pranimit të punëve të realizuara, sipas kërkesës kualifikuese. Sipas dispozitave ligjore nga neni 69 i LPP-së, si prova dhe dëshmi nuk pranohet përdorimi i fotografive, ashtu siç është përcaktuar edhe me dispozita të tjera nënligjore. Realizimi i kontratës paraprake argumentohet me dokumente ligjore, siç janë raportet përfundimtare të realizimit të 7/10 punimeve dhe dokumentet tjera. Pavarësisht kësaj, ne si grup i OE-ve në ofertë kemi paraqitur fotografi të punëve paraprake, të argumentuara me referenca. Mosaplikimi i fotografisë në formularin e caktuar nuk e bën ofertën tonë të papërgjegjshme dhe as nuk ndryshon faktin se ne si grup i OE-ve kemi realizuar projektet e dorëzuara në ofertë. Madje, në aneksin/tabelën 1 nuk ka pasur vend të specifikuar për vendosjen e fotografive. Po ashtu, anekset/tabela 1 kanë qenë për plotësimin e të dhënave për projektin dhe, për këtë arsye, nuk ka mundur të vendosen fotografi të të dhënave. Kjo arsye eliminuese nuk ka të bëjë as me

kërkesat e Dosjes Tenderit (DT) e as me plotësimin e aneksit, për arsye se ne kemi paraqitur anekset dhe fotografitë për secilin projekt. Po ashtu, ka dëshmi të mjaftueshme për të argumentuar që ne kemi realizuar projektet dhe se ato plotësojnë kërkesat e vendosura nga AK në DT. Secili dokument është i qartë dhe dëshmon kapacitetin profesional të konsorciumit tonë".

Pretendimi i tretë (3): Ankuesi pretendon se "Arsyetimi i tretë i eliminimit të grupit të OE-ve ankues dhe arsyetimi se në CV-në e znj. Ylfete Tahiraj, inxhiniere e Arkitekturës, nuk është e vulosur, nuk është i bazuar, për faktin që në vlerësimin e parë të këtij tenderi, ju si AK, më datë 23.05.2024, na keni dërguar një letër standarde të kërkesës për sqarim të tenderit, duke kërkuar sqarim lidhur me të njëjtën arsye. Së bashku me sqarimet e kërkuara, kemi theksuar që ne kemi paraqitur dy arkitektë, ku znj. Ferdeze Kastrati i ka plotësuar kërkesat e Dosjes së Tenderit (DT), dhe arkitektja tjetër, znj. Ylfete Tahiraj, është gjithashtu pjesë e stafit të konsorciumit tonë. Në rast se ka nevojë për angazhim eventual, ne si OE ankues kemi paraqitur këto sqarime dhe i kemi ngarkuar në e Prokurim më datë 28.05.2024, të cilat mund të gjenden si prova. Andaj, konsiderojmë që kjo arsye eliminuese është e pabazuar dhe e pa mbështetur në kërkesat e Dosjes së Tenderit (DT), pasi që kërkesën 1.1 e kemi të plotësuar me arkitektin znj. Ferdeze Kastrati. Për kërkesën 1.1 – një udhëheqës kryesor i arkitekturës, kemi paraqitur znj. Ferdeze Kastrati, e cila ka plotësuar të gjitha dëshmitë e kërkuara. Po ashtu, në sqarimet e bëra më datë 28.05.2024, ju kemi ngarkuar edhe CV-në e vulosur të znj. Ylfete Tahiraj, dhe gjatë fazës së rivlerësimit keni pasur mundësinë të kërkoni sqarime shtesë, bazuar në nenin 72 të LPP-së. Provë sqarimet e ngarkuara në e-prokurim me dt.28.05.2024".

Pretendimi i katërt (4). Ankuesi pretendon se: "Arsyeja eliminuese lidhur me mungesën e dëshmive për paisjet të cilat janë evidentuar në Vendimin për eliminimin e konzorciumit tonë për pikat e kërkesave të makinerive për pikat 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, 1.15, 1.16, 1.20, 1.21, 1.23, 1.24, është e pabazuar, për faktin që AK-MKRS ka kërkuar sqarime më datë 23.05.2024 në vlerësimin e parë. Ne, sipas kërkesës së AK-së, më datë 28.05.2024 kemi ngarkuar sqarimet e kërkuara dhe kemi argumentuar se të gjitha paisjet e 8/10 kërkuara janë në dispozicionin tonë, duke ofruar dëshmi dhe foto që janë ekzistuese dhe para skadencës së afatit për hapjen e ofertave. Andaj, konsiderojmë se përshkrimi i këtyre gjetjeve tregon qartë për një qëllim të caktuar të realizuar nga zyrtarë të caktuar, për një kompani të caktuar, përmes veprimeve ose mosveprimeve, të cilat konsiderohen si shkelje të rënda të Ligjit për Prokurim Publik. Gjatë vlerësimit të ofertave, madje edhe gjatë ri-vlerësimit të tyre, nuk janë marrë për bazë dëshmitë dhe provat e dorëzuara me ofertë, apo ato të dorëzuara pas kërkesave për sqarim dhe plotësim. Si rrjedhojë, sipas nenit 59, paragrafi 1 të Ligjit për Prokurim Publik, përgjegjësia ligjore bie mbi çdo anëtar të komisionit vlerësues, veç e veç. Provë sqarimet e ngarkuara me dt.28.05.2024 në eporkurim Sipas nenit 10 të Udhëzuesit me nr. 001/2022 për Prokurim Publik, pika 10.1 jepen shembujt, ku theksohet se këto nuk janë rastet e vetme dhe Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së. Të gjitha arsyetimet e eliminimit të grupit të OE-ve ankues janë arsyetime që nuk gjejnë mbështetje ligjore. Madje, për të gjitha pasigurie eventuale të shfaqura, edhe pse ato nuk ekzistojnë, Autoriteti Kontraktues është i detyruar të kërkojë sqarime shtesë, në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP)".

Pretendimi i pestë (5): Ankuesi pretendon se: "Teksti i përmirësuar: Arsyeja tjetër eliminuese lidhur me mungesën e skeleve lëvizëse, kinse nuk kemi paraqitur dëshmi për 200 m² skele, është e pabazuar. Po ashtu, arsye të tjera të ngjashme vlerësojmë se OSHP, eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues duhet ti marrin në konsideratë dispozitat ligjore 9/10 të Ligjit për Prokurim Publik dhe të ushtrojnë autoritetin e tyre për të ndërmarrë veprime ligjore për tentativat e

eliminimit të ofertës sonë me arsyetime të tilla. Sipas pikës d) të nenit 97 të Rregullores për Prokurim Publik, mosrespektimi dhe shkelja e parimeve të prokurimit publik të përcaktuara me LPP, konsiderohet si shkelje e rëndë. Po ashtu, pika o) përcakton se provat që dëshmojnë për sjellje të gabuar ose jo profesionale të zyrtarëve të prokurimit në raport me OE, janë gjithashtu të dëmshme. Arsyetimet e tilla tregojnë për një qëllim të caktuar dhe favorizim të një kompanie të caktuar, ku tani është e qartë se kjo kompani për këtë procedurë prokurimi nuk mund të kualifikohet si përgjegjëse. Grupi ynë i OE-ve në ofertë ka paraqitur dokumentin doganor me nr. R6748, ku janë të evidentuara artikujt e skelerisë të përdorur. Përfshirë këtu shtyllat (=1400 cm), aksesorët (shina =2200 cp, lidhës= 180 cp, skele =10 cp) me një total prej 3790 copë dhe peshë totale 18600 kg. Po ashtu, në këtë dokument doganor është e evidentuar edhe skele lëvizëse e përdorur me rrota prej alumini, e cila është 1 copë dhe ka peshë 200 kg. Skeleria lëvizëse është pjesa e fundit që mbështet në tokë dhe ka rrota, mbi të cilën mund të vendosen skeleri në lartësinë e nevojshme, duke krijuar mundësinë që të arrijmë mijëra metra katrorë. Kjo çështje është e njohur nga zyrtarët përgjegjës të AK-MKRS, por pavarësisht kësaj, çuditërisht po bëhet një përpjekje për të eliminuar ofertën tonë. Madje, jo vetëm që e plotësojmë këtë kërkesë, por edhe e tejkalojmë dukshëm. Si rrjedhojë, OSHP dhe përkatësisht ekspertët shqyrtues eventualë, të autorizuar dhe të aftë në këtë fushë, duhet të kërkojnë sqarime ose mbështetje profesionale nga ekspertë të fushës përkatëse – si inxhinierë të ndërtimit – në mënyrë që të paraqitet gjendja faktike në mënyrë të qartë".

Pretendimi i gjashtë (6): Ankuesi pretendon se: "Arsyeja tjetër e eliminimit, lidhur me mungesën e dëshmisë për dy kontenierë industrialë, nuk është e bazuar, për shkak se në ofertën tonë kemi paraqitur faturën e blerjes për dy kontenierët me sipërfaqe 15m², dhe kemi bashkangjitur edhe fletëpagesën e kontenierëve për faturën me nr. 24-FSH-006 të datës 27.03.2024, si dhe konfirmimin bankar përkatës. Provë 29 dokumentacioni me ofertë folder 18.Makineria -H1.3 Kontinjer industrial Duke u bazuar në ato që potencuam më sipër, konsiderojmë se AK, edhe pse në fazën vlerësuese ka kërkuar sqarime për të njëjtat arsye, tani në fazën rivlerësuese ka evidentuar si të gjetura këto arsye, që tregon për një qëllim të caktuar dhe mos rekomandim të kompanisë sonë. Kjo çështje dhe shkeljet ligjore, shkeljet e parimeve të prokurimit dhe abuzimi i tillë, do duhej të ishin shqetësuese për Autoritetin Kontraktues dhe të ishin të ndëshkuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, dhe jo vetëm. Si përfundim, bazuar në provat dhe faktet e sipër argumentuara, ne si Grup i Ofruesve, me përgjegjësi profesionale, kemi përgatitur dhe ofertuar në këtë procedurë të prokurimit. Si rrjedhojë, procedura e prokurimit e inicuar dhe publikuar nga AK – MKRS, ka të përcaktuara 10/10 kriteret e dhënies së kontratës dhe kriteret e vlerësimit".

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 02/12/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1151/2024, i cili është dorëzuar me datë 22/12/2024.

Lidhur me pretendimet e OE "Construmax SH.P.K." eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1151 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Sipas pretendimi ankimor nr 1 operatori ekonomik ankues pretendon si ne vijim: Arsyetimi i parë eliminuese lidhur me vlerësimin e gjendjes ekonomike dhe financiare nuk është i bazuar, për faktin se kërkesa në Doshjen Teknike (DT) ka qenë që për tre vitet e fundit fiskale të dështmohet se ka pasur të ardhura minimale prej 9,000,000.00 €. Data e publikimit të DT-së ka qenë më 07.03.2024, dhe për tri vitet e shkuara fiskale, jo vetëm që e plotësojmë këtë kërkesë, por edhe e tejkalojmë me rreth 2 milion euro. Kjo pasi që vetëm të hyrat pa TVSH janë 9.9 milion euro, ndërsa nëse llogaritim edhe TVSH-në, e cila ka qenë e njëjta vlerë si e ardhura, atëherë arrijmë në 11.7 milion euro. Kërkesa ne dosje te tenderit për ketë pretendim ankimor është si në vijim: Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik-Konsorciumi, duhet të ofrojë dëshmi të gjendjes ekonomike dhe kapacitetit financiar për të përmbushur kërkesat e lëndës së kësaj procedure; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve fiskale të shkuara- 2020, 2021 dhe 2022, ka siguruar të ardhura minimale vjetore bruto, në vlerë mbi 9,000,000.00 € [Nëntë, zero-zero-zero, zero-zero-zero. zero-zero euro]. Dëshmia ne dosje te tenderit për ketë pretendim ankimor është si në vijim: Dëshmia e kërkuar dokumentare-Kërkesa 1.2. Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik- Konsorciumi, duhet të dorëzoj dokumentacionin ne vijim, për secilin nga tre [3] vitet fiskale te shkuara- 2020, 2021 dhe 2022.

- Raportet financiare dhe raportet e menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim; Në rast të Grupit të operatoreve ekonomik- Konsorciumit, dëshmia duhet të dorëzohet ne veçanti për secilin Operator ekonomik

- Një [1] kopje e origjinalit, e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori ekonomik Grupi i operatoreve ekonomik- Konsorciumi.

- Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka ofertuar ne lidhje me ketë pretendim ankimor si ne vijim: Fillimisht duhet sqaruar faktin se kërkesa në dosje te tenderit ne lidhje me ketë kriter ka qenë si kërkesë në 3 vitet fiskale te shkuara -2020,2021 dhe 2022, qe ne fakt tri vitet fiskale te shkuara duhet përfshirë vitin 2023, sepse edhe neni 68 Kërkesat mbi gjendjen ekonomike financiare thotë : Kërkesat mbi gjendjen ekonomike duhet të shprehen detyrimisht në shifra dhe do ti referohen maksimum tri viteve të fundit financiare.

Bazuar ne te hyrat vjetore nga raportet e auditorit te pavarur te licensuar rezulton se GOE Construmax dhe HARST Group e plotëson kërkesën minimale vjetore bruto se te hyrat e prezentuara ne pasqyrat vjetore për vitet e shkuara financiare e tejkalojnë shumën mbi 9,000.000.00€. Ne nuk do te i paraqesim me shumë detaje për arsye se Gjendja Ekonomike dhe financiare është përfshirë si sekret afarist nga OE ankues.

Pasqyrat financiare te GOE ankues janë te përfshira ne ofertë tek Kapaciteti Financiar me nr rendor 2 dhe 3.rar. Nga përshkrimi i mësipërme konstatojmë se pretendimi ankimor nr. 1 është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Sipas pretendimi ankimor nr. 2 operatori ekonomik ankues pretendon si ne vijim: Arsyetimi i dytë i eliminimit lidhur me mungesën e fotografive në formularin Aneksin/Tabelën 1 është një arsyetim i pabazuar në kërkesat e Dosjes Teknike (DT), për arsye se në dëshmitë e kërkuara dokumentare ka qenë e specifikuar që ,, duhet te paraqes informacion mbi secilën kontrate për pune ndërtimore te zbatuar- nëpërmjet paraqitjes se të dhënave tekstuale dhe numerike, si dhe fotografive, në katër [4] faqe [bashkërisht me tabelën në vijim] me madhësi A4'. Eksperti shqyrtues sqaron se GOE ankues tek fajllat me nr rendor

5,6.7.8 kontrata.rar ka te përfshira edhe fotot e projekteve te realizuara. Edhe vet AK-MKRS ne përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim e pranon se OE ankues ka ngarkuar foto ne format tjetër dhe ndërlidhja e tyre me tabelën e paraqitur ishte e vështirë për realizim. Andaj ne rast te vështirësive te tilla AK-MKRS ka mundur te kërkoj sqarime shtesë sipas nenit 72 te LPP-se dhe nenit 38 te Rregullores për Prokurim Publik nr 001/2022, sepse OE ka përfshirë ne ofertën e tij numër te caktuar te fotove qe paraqesin realizimin e projekteve te tilla. Përveç fotove te përfshira po ashtu, ka dëshmi tjera ne ofertën e GOE ankues brenda fajllave me nr rendor 5,6.7.8 kontrata.rar, që janë paraqitur si dëshmi te realizimit te projekteve siç janë referencat, raporte te pranimit teknik etj. Nga përshkrimi i mësipërme konstatojmë se pretendimi ankimor nr. 2 është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Sipas pretendimi ankimor nr. 3 operatori ekonomik ankues pretendon si ne vijim: Arsyetimi i tretë i eliminimit të grupit të OE-ve ankues dhe arsyetimi se në CV-në e znj. Ylfete Tahiraj, inxhiniere e Arkitekturës, nuk është e vulosur, nuk është i bazuar, për faktin që në vlerësimin e parë të këtij tenderi, ju si AK, më datë 23.05.2024, na keni dërguar një letër standarde të kërkesës për sqarim të tenderit, duke kërkuar sqarim lidhur me të njëjtën arsye. Eksperti shqyrtues sqaron se AK-MKRS me datës sqaron se AK-MKRS me datë 23.05.2024 ka kërkuar sqarime shtesë duke përfshirë edhe sqarimin ne lidhje me vulosjen e CV-se te znj. Ylfete Tahiraj. OE Construmax me dt. 28.05.2024 ka kthyer përgjigjet si ne vijim: Me kemi paraqitur dy arkitektë, ku znj. Ferdeze Kastrati i ka plotësuar kërkesat e Dosjes së Tenderit (DT), dhe arkitektja tjetër, znj. Ylfete Tahiraj, është gjithashtu pjesë e stafit të konsorciumit tonë. Në rast se ka nevojë për angazhim eventual, ne si OE ankues kemi paraqitur këto sqarime dhe i kemi ngarkuar në E-Prokurim më datë 28.05.2024, të cilat mund të gjenden si prova. Andaj përpos që kërkesën e DT e plotëson znj. Ferdeze Kastrati, po ashtu kërkesën në DT e plotëson edhe znj Ylfete Tahiraj, për arsye që në CV e saj ka të evidentuar përvojë 4 vite në Harst Group shpk, po ashtu ka të prezantuar edhe përvojë para diplomimit, si dhe ka përvojë edhe në Polici në vitin 2008 pas diplomat, që nëse kalkulohen vetëm përvoja në Polici dhe në Harst Group plotëson 5 vite përvojë, mirëpo znj. Ylfete Tahiraj edhe pse nuk e ka të evidentuar përvojën në NTP,, JETA' 'në CV ndërsa ka të prezantuar referencë nga NTP,,JETA"', ne bashkëngjisim kontributet pensionale për të vërtetuar që ka qenë e punësuar në këtë ndërmarrje dhe plotëson kërkesën prej 5 vite. Bazuar ne përshkrimin e mësipërm te sqarimeve shtesë të kërkuara nga AK-MKRS dhe përgjigjeve te dërguara nga OE Construmax me datë 28.05.2024 sqarojmë se ky pretendim ankimor është sqaruar ne fazën e vlerësimit te tenderëve dhe si rezultat i kësaj nuk ka qen si e gjetur ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar sipas vendimit te AK-se te datës 12.07.2024. Ne bazë te kësaj le te kuptohet se komisioni i vlerësimit i ka pranuara sqarimet si te bazuara ne lidhje me ketë pretendim ankimor. Sipas nenit 59, paragrafi 4 i cilit thotë: Autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse:

(i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë,ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Andaj mos vulosja e CV mund te trajtohet si një devijim i vogël qe nuk shkakton ndryshime materiale ne dosje te tenderit apo ne njoftimin për kontratë. Sipas përshkrimit te mësipërm, sqarimeve te dosjes se tenderit te ofruara nga OE ankues, ofrimit te dy CV për dy arkitekt ku është ofruar edhe CV e znj. Ferdeze Kastrati qe ka vulën nga OE Construax, mendojmë qe

pretendimi ankimor nr. 3 është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4: Sipas pretendimi ankimor nr. 4 operatori ekonomik ankues pretendon si ne vijim: Arsyeja eliminuese lidhur me mungesën e dëshmive për paisjet të cilat janë evidentuar në Vendimin për eliminimin e konzorciumit tonë për pikat e kërkesave të makinerive për pikat 1.7, 1.8, 1.9, 1.10, 1.11, 1.15, 1.16, 1.20, 1.21, 1.23, 1.24, është e pabazuar, për faktin që AK-MKRS ka kërkuar sqarime më datë 23.05.2024 në vlerësimin e parë. Ne, sipas kërkesës së AK-së, më datë 28.05.2024 kemi ngarkuar sqarimet e kërkuara dhe kemi argumentuar se të gjitha paisjet e 8/10 kërkuara janë në dispozicionin tonë, duke ofruar dëshmi dhe foto që janë ekzistuese dhe para skadencës së afatit për hapjen e ofertave. Po ashtu ne lidhje me ketë perëndim ankimor janë kërkuar sqarimet gjatë fazës se vlerësimit te ofertave , ku OE Construmax me datë 28.05.2024 ka kthyer sqarimet përmes E-prokurimit. Sqarojmë se ky pretendim ankimor është sqaruar ne fazën e vlerësimit te tenderëve dhe si rezultat i kësaj nuk ka qen si e gjetur ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar sipas vendimit te AK-se te datës 12.07.2024. Ne bazë te kësaj le te kuptohet se komisioni i vlerësimit i ka pranuara sqarimet si te bazuara ne lidhje me ketë pretendim ankimor. Ne fajllat me nr rendor 17 Makineria.rar janë paraqitur pajisjet me nr. rendor 1.1 deri 1.18 dhe fajllin nr. 18 Makineraria. Rar po ashtu janë paraqitur pajisjet me nr. rendor 1.19 deri 1.24. Lista e pajisjeve ne fajllin nr 17 Makineria.rar.

Ne bazë te vendimit te AK-se te datës 19.11.2024, si përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim tek pretendimi ankimor nr 4, AK i referohet mungesës se disa pajisjeve, japim disa sqarime si ne vijim: Sipas AK-MKRS mungon ne tërësi pajisja ne 1.7. Eksperti shqyrtues sqaron se një pajisje me nr rendor 1.7 gjendet ne fajllin nr 17 Makineria.rar me emërtim Kompaktor dheu me rul te rrafshet 60 kN. Sipas AK-MKRS, tek pajisja 1.9 mungojnë specifikacionet teknike ashtu siç janë kërkuar. Eksperti shqyrtues sqaron se AK-MKRS ne këto raste duhet te saktësoj se cilat janë specifikacionet teknike qe janë kërkuar dhe nuk janë plotësuar nga OE ankues ne ketë aktivitet te prokurimit. Ne follderin 1.16 sipas AK-MKRS është bashkangjitur Eskavator dhe jo traktor. Eksperti shqyrtues sqaron se ne ketë fajll saktësisht ne fq 7 është prezantuar edhe foto e traktorit ndërsa ne fq 8 edhe fatura e blerjes se traktorit.

Po ashtu ne lidhje me ketë pretendim ankimor janë kërkuar sqarimet gjatë fazës se vlerësimit te ofertave, ku OE Construmax me datë 28.05.2024 ka kthyer sqarimet përmes E-prokurimit ne lidhje me pasjisjet e ofruara me nr rendor nga 1.1 deri 1.24. Edhe ky pretendim ankimor është sqaruar ne fazën e vlerësimit te tenderëve dhe si rezultat i kësaj nuk ka qen si e gjetur ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar sipas vendimit te AK-se te datës 12.07.2024. Ne bazë te kësaj le te kuptohet se komisioni i vlerësimit i ka pranuara sqarimet si te bazuara ne lidhje me ketë pretendim ankimor. Sidoqoftë për te gjitha paqartësitë ne raste te tilla AK-MKRS, ne lidhje me pretendimin ankimor nr 4, komisioni i rivlerësimit te veproj sipas nenit 72 te LPP-se dhe nenit 38 te Rregullores për Prokurim Publik, pra të kërkohen sqarimet e nevojshme shtesë ne lidhje me paqartësitë eventuale. Andaj bazuar ne përshkrimin e mësipërm, sqarimet shtesë te datës 28.05.2024, pretendimeve nga komisioni i rivlerësimit mendojmë qe pretendim ankimor nr. 4 është pjesërisht i bazuar dhe sqarimet e nevojshme te bëhen ne fazën e rivlerësimit te ofertave.

Përgjigje në pretendimin ankimor 5: Sipas pretendimi ankimor nr. 5 operatori ekonomik ankues pretendon si ne vijim: Arsyeja tjetër eliminuese lidhur me mungesën e skeleve lëvizëse, kinse nuk kemi paraqitur dëshmi për 200 m² skele, është e pabazuar. Grupi ynë i OE-ve në ofertë ka paraqitur dokumentin doganor me nr. R6748, ku janë të evidentuara artikujt e skelerisë të përdorur. Përfshirë këtu shtyllat (=1400 cm), aksesorët (shina =2200 cp, lidhës= 180 cp, skele

=10 cp) me një total prej 3790 copë dhe peshë totale 18600 kg. Po ashtu, në këtë dokument doganor është e evidentuar edhe skele lëvizëse e përdorur me rrota prej alumini, e cila është 1 copë dhe ka peshë 200 kg.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne fajllin rendor nr 18 Makineria.rar gjendet DUD-i doganor i paraqitur nga OE ankues me nr R6784. Në ketë DUD janë te paraqitura artikujt e skeleve te përdorura sipas sasive dhe përshkrimeve te DUD. Përveç kësaj OE ankues ne pjesën lart te DUD ka bërë një përshkrim te skeleve si ne vijim: H. 1.2. Skele lëvizëse me rrote [‘Mobile scaffolding’].

Skelet lëvizëse me rrotë përfshijnë të gjitha elementet strukturore, të sigurisë dhe funksionale. Dyqind [200] m2 në projeksion vertikal. Edhe vet AK-MKRS ne përgjigjen ndaj Kërkesës për Rishqyrtim e pranon se ekziston DUD mirëpo theksohet se ne DUD shkruan kg dhe jo metër katror. Ne raste te tilla nëse AK-MKRS dyshon ne sasinë e kg apo metrave katror ka mundur te kërkoj sqarimet e nevojshme apo te angazhoj ekspert te caktuar nëse sasia e skeleve te ofruara sipas DUD-I i plotëson metrat katror, edhe pse OE ankues ka dhënë sqarimet e nevojshme ne DUD për Dyqind [200] m2 në projeksion vertikal. Bazuar ne përshkrimin e mësipërm, DUD doganor te ofruar nga OE ankues dhe kërkesës se AK-MKRS mendojmë se pretendimi ankimor nr. 5 është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin ankimor 6: Sipas pretendimi ankimor nr. 6 operatori ekonomik ankues pretendon si ne vijim: Arsyeja e eliminimit, lidhur me mungesën e dëshmisë për dy kontenierë industrialë, nuk është e bazuar, për shkak se në ofertën tonë kemi paraqitur faturën e blerjes për dy kontenierët me sipërfaqe 15m², dhe kemi bashkangjitur edhe fletëpagesën e kontenierëve për faturën me nr. 24-FSH-006 të datës 27.03.2024, si dhe konfirmimin bankar përkatës. Eksperti shqyrtues sqaron e ne fajllin nr 18 Makineria.rar gjendet dokumenti H 1.3 Kontinjer Industrial.pdf (fatura dhe dëshmi e pagesës) për kontinieret me përshkrim si ne vijim: Fatura është me datë 27.03.2024 dhe po ashtu dëshmia e pagesës ka datë 27.03.2024. Sipas përshkrimit ne faturë janë dy kontinier nga 15 m2. Andaj pretendimi i AK-MKRS ne vendimin e datës 19.11.2024 si përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim ku theksohet se lidhur me kontininer industrial është një faturë nga GAMP e cila nuk është pranuar fare nga Construmax , nuk qëndron ky fakt sepse OE ankues ka bashkangjitur dëshminë e pagesës te kësaj fature.

Bazuar ne përshkrimin e mësipërm, faturën e ofruar nga OE ankues, dëshminë e pagesës të bërë nga OE ankues ne lidhje me dy kontiner sipas faturës se datës 27.03.2024 mendojmë se pretendimi ankimor nr.6 është i bazuar. Në bazë te pretendimeve ankimore sipas ankesës se OE ankues sqarojmë se ankesa përmban 6 pretendime ankimore si ne vijim: Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, sqarimeve te kërkuara nga AK, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i ri-vlerësimit, nuk ka respektuar ne tërësi te gjitha dispozitat ligjore te LPP-se gjatë procedurës se vlerësimit sipas përshkrimit te mësipërm për secilin pretendim ankimor andaj sipas nenit 114 te LPP-se saktësisht paragrafi 2 i këtij neni rekomandojmë qe AK ne procedurën e Rivlerësimit te i ndërmerr te gjitha veprimet e nevojshme korrigjuese. Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të ri-vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të bëhet ne harmoni te plotë me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies. Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te

përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike. Nga përshkrimi i mësipërm te secilit pretendim ankimor, sqarimet e pranuara ne fazën e vlerësimit te ofertave, dosjes se tenderit, pretendimeve ankimore te operatorit ekonomik ankues , raportit te rivlerësimit te AK-MKRS, Vendimit te AK-MKRS te datës 29.11.2024 si përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim, po ashtu bazuar ne nenin 6 dhe nenin 7 të LPP-së, rekomandojmë panelin shqyrtues: ankesa e Construmax shpk te aprovohet si e bazuar, lënda të kthehet në Ri-Vlerësim, të Anulohet njoftimi mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit i datës 08.11.2024.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues nuk është pajtuar me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërkaq operatori ekonomik është pajtuar për mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, ku nga OSHP-ja kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit ‘’Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Qendrës Nacionale të Xhudos-Palestrës, Ndërtesës shumë-funksionale dhe Bujtinës, në Pejë, në Komunën e Pejës- Ri-tenderim me numër të prokurimit 207-24-2051-5-1-1.

Paneli Shqyrtues për këtë procedur të prokurimit Autoriteti Kontraktues bazuar në të gjeturat në përmes plaformës elektronike sipas publikimit të B58 Njoftim mbi vendimin e AK të datës 12.07.2024, Autoriteti Kontraktues sipas formularit për eliminim ka eliminuar ofertën e OE ankues me arsyetime e që kanë dallime esencial ne raport me rivlersimin, dhe sipas publikimit të B58 Njoftim mbi vendimin e AK-së të datës 08.11.2024.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në ketë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës i

përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK-ja gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, ngase raporti i vlersimit të më hershëm dhe rivlersimit lidhur me ofertën e OE ankues lidhur me rezultatin e oferës ka dallime esenciale, Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor] të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin e Qendrës Nacionale të Xhudos- Palestrës, Ndërtesës shumë-funksionale dhe Bujtinës, në Pejë, në Komunën e Pejës- Ri-tenderim" me numër të prokurimit 207-24-2051-5-1-1, dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe AK-ja gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërsi dispozitave ligjore të LPP-së,

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për pikën I, II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahimi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- OE - **CONSTRUMAX SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: